



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 qershor 2014  
Nr.ref.: RK 642/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastet e bashkuara nr.**

**KI228/13**

**KI04/14**

**KI11/14**

**KI13/14**

Parashtrues

**Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj së bashku në rastin nr. KI228/13, dhe  
Lulzim Ramaj ndaras në rastet nr. KI04/14, KI11/14, KI13/14**

**Rasti. nr. KI228/13**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit,  
KMLP. I. nr. 11/13, të 5 gushtit 2013, përkitazi me Aktvendimin për  
papranueshmëri të rastit nr. KI126/10, të Gjykatës Kushtetuese, të 19  
janarit 2012; Aktvendimit për papranueshmëri, Rastin nr. KI32/11, të  
Gjykatës Kushtetuese, të 20 prillit 2012; dhe të Aktvendimit për  
papranueshmëri, Rasti nr. KI102/11, të Gjykatës Kushtetuese, të 12  
dhjetorit 2011**

**Rastet nr. KI04/14, KI13/14**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Zyrës së Prokurorit  
Disiplinor, ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011, lidhur me Vlerësimin e  
kushtetutshmërisë së Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr.  
KI32/11, i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012**

**Rasti nr. KI11/14**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 470/13, të Gjykatës  
Themelore në Pejë, të 27 qershorit 2013**

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa KI228/13 është dorëzuar nga z. Lulzim Ramaj dhe znj. Shahe Ramaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), me vendbanim në Pejë, përderisa kërkesat KI04/14, KI11/14 dhe KI13/14 ishin dorëzuar nga parashtruesi Lulzim Ramaj.

### **Vendimi i kontestuar**

#### ***A. Sa i përket kërkesës KI228/13***

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Njoftimin KMLP. I. nr. 11/13, të Prokurorit të Shtetit, të 5 gushtit 2013, i cili u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 7 gusht 2013.
3. Për më tepër, në kërkesën KI228/13, parashtruesit e kërkesës ankohen ndaj Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr. KI126/10 i Gjykatës Kushtetuese, të 19 janarit 2012; Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr. KI32/11, të Gjykatës Kushtetuese, të 20 prillit 2012; dhe Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr. KI102/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 12 dhjetorit 2011.

#### ***B. Sa i përket kërkesës KI11/14***

4. Parashtruesi i kërkesës, Lulzim Ramaj e konteston Aktvendimin P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, të 27 qershorit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 15 korrik 2013.

#### ***C. Sa i përket kërkesave KI04/14 dhe KI13/14***

5. Parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj e konteston Vendimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011, i cili i është dorëzuar atij më 9 shkurt 2011.
6. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj, në kërkesat KI04/14 & KI11/14 ankohet se Aktvendimi për papranueshmëri, Rasti nr. KI32/11 i



Gjykatës, i 20 prillit 2012, është “i paligjshëm, i mungon arsyetimi dhe se nuk është dashur të publikohet”.

### **Objekti i çështjes**

7. Objekt i çështjes së kërkesës KI228/13 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit KMLP. I. nr. 11/13 të Prokurorit të Shtetit të 5 gushtit 2013 sepse “[...]Edhe vendimi i Prokurorit të shtetit bie ndesh me nenin 392 të KPK-së [Kodi Penal i Kosovës], për nxjerrje të vendimeve kundër ligjore sepse në dosje ekzistojnë të gjitha shkresat e lëndës dhe Prokurori nuk ka dhënë asnjë shpjegim ligjor në të cilën e mbështetë vendimin e vetë.”, në lidhje me Aktvendimin për papranueshmëri rasti nr. KI126/10 i Gjykatës Kushtetuese, i 19 janarit 2012; Aktvendimin për papranueshmëri rasti nr. KI32/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012; dhe Aktvendimin për papranueshmëri rasti nr. KI102/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 12 dhjetorit 2011. Ata nuk janë të kënaqur me aktvendimet e Gjykatës, sepse ata konsiderojnë që “[...] Gjykata Kushtetuese nuk më ka shpjeguar pse nuk i kam shteruar të gjitha mjetet juridike, kur e kam paraqitur kërkesën në Ministrinë e Pushtetit Lokal për ndërtimin e shtëpisë sime...Gjykata e ka publikuar vendimin në kundërshtim me nenin 17.2.3. të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese edhe pas kërkesës time që vendimi të mos publikohet. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim kundërligjor nga neni 346 I KPK-së”.
8. Objekt i çështjes së kërkesës KI11/14 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 470/13 të Gjykatës Themelore në Pejë, të 27 qershorit 2013, sepse “Mos ndihma shtetërore për të na dalë në ndihmë ligjore për ndërtimin shtëpisë dhe pasi ka ardhë për të verifikuar rastin dhe na ka premtuar se do të na sjellë materialin ndërtimor, bie ndesh me nenin 3 (Barazia para Ligjit), nenin 16 (Epërsia e Kushtetutës), nenin 17 (Marrëveshjet Ndërkombëtare), nenin 18 (Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare), nenin 19 (Zbatimi i së drejtës Ndërkombëtare), 21, paragrafi 1 (Parimet e Përgjithshme), nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) nenin 24, paragrafi 1 (Barazia para Ligjit), nenin 31 (E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe te Paanshëm), nenin 53 (Interpretimi i dispozitave për të drejtat e Njeriut) dhe nenin 54 (Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Kosovës nenin 1, nenin 2, paragrafi 1, nenin 7, nenin 8 dhe nenin 29, paragrafi 2, të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; nenin 2, paragrafi 1 (a) dhe (b), nenin 5, paragrafi 11 dhe 2, nenin 8, paragrafi 2, nenin 14, paragrafi 1, nenin 25, paragrafi 1 dhe nenin 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 1 (E drejta për të respektuar të drejtat e njeriut), nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve të saj”.
9. Objekt i çështjes së kërkesës KI04/14 dhe KI13/14 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011 sepse “Refuzimi i dhënies së vërtetimit të pjesëtarit të UÇK-së dhe mohimi i njohjes së statusit të pjesëtarit të UÇK-së, publikimi i rastit në media dhe shpifjet nga OVL e UÇK-së, bie ndesh me nenin 21, paragrafi 1, nenin 24, paragrafi 1, nenin 36, paragrafi 1 dhe nenin 41, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 1, nenin 2, paragrafi 1, nenin 7, nenin 8 dhe nenin 29, paragrafi 2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e



*Njeriut, nenin 2, paragrafi 1 (a) dhe (b), nenin 5, paragrafi 11 dhe 2, nenin 8, paragrafi 2, nenin 14, paragrafi 1, nenin 25, paragrafi 1 dhe nenin 26 te Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, nenin 1 (E drejta për të respektuar të drejtat e njeriut), nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) te Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve te saj”, në lidhje me Aktvendimin për papranueshmëri, rasti KI32/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012. Ai nuk është i kënaqur me Aktvendimin e Gjykatës, sepse konsideron se “është i paligjshëm, i mungon arsytimi dhe se nuk është dashur të publikohet”.*

10. Për më tepër, në të gjitha kërkesat, parashtruesit kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet bazuar në “nenin 17.2.3 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nenin 36, paragrafi 1 i Kushtetutës së Kosovës, dhe nenet 1 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe Protokollet e saj”.

#### **Baza juridike**

11. Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në Rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

#### **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

12. Më 7 dhjetor 2013, parashtruesit Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj e dërguan me postë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Kërkesa kishte arritur në Gjykatë më 10 dhjetor 2013 dhe ishte regjistruar me numrin KI228/13.
13. Më 15 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI228/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI228/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
14. Më 16 janar 2014, parashtruesi Lulzim Ramaj parashtrroi kërkesë në Gjykatë. Kërkesa ishte regjistruar me nr. KI04/14.
15. Më 23 janar 2014, parashtruesi Lulzim Ramaj parashtrroi kërkesë në Gjykatë. Kërkesa ishte regjistruar me nr. KI11/14.
16. Më 24 janar 2014, parashtruesi Lulzim Ramaj parashtrroi kërkesë në Gjykatë. Kërkesa ishte regjistruar me nr. KI13/14.
17. Më 3 shkurt 2014, Kryetari i Gjykatës, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, me Vendimin Urdh. KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14, urdhëroi bashkimin e kërkesave KI04/14, KI11/14 dhe KI13/14 me kërkesën KI228/13.

18. Më 7 shkurt 2014, në pajtim me rregullin 37 të Rregullores së punës, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave.
19. Më 24 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

### ***A. Kërkesa KI228/13***

20. Më 5 mars 2012, parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj parashtroi padi private në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Gjykatës për nxjerrjen e paligjshme të Aktvendimeve KI102/11, KI32/11 dhe KI126/10 sipas nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës sepse Gjykata Kushtetuese “... nuk më ka shpjeguar pse nuk i kam shteruar të gjitha mjetet juridike, kur e kam paraqitur kërkesën në Ministrinë e Pushtetit Lokal për ndërtimin e shtëpisë sime...Gjykata e ka publikuar vendimin në kundërshtim me nenin 17.2.3. të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese edhe pas kërkesës time që vendimi të mos publikohet. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim kundërligjor nga neni 346 I KPK-së”.
21. Më 27 mars 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin P. nr. 803/11, e hodhi poshtë padinë private të Lulzim Ramajt si të pabazuar.
22. Ankesa pasuese nga parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj ishte hedhur poshtë si e pabazuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës (Aktvendimi PA1. nr. 407/2013, të 17 majit 2013).
23. Më 5 gusht 2013, Prokurori i Shtetit, (Njoftimi KMLP. I. nr. 11/13), e njoftoi parashtruesin e kërkesës se Prokurori i Shtetit nuk kishte gjetur bazë ligjore të vazhdojë me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.

### ***B. Kërkesa KI11/14***

24. Më 5 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj ka kërkuar nga Drejtoria për Rindërtim në Komunën e Pejës që t'i sigurojë atij material të nevojshëm për rindërtimin e shtëpisë së tij.
25. Sipas parashtruesit të kërkesës, Drejtoria për Rindërtim nuk i siguroi atij materialin e kërkuar për ndërtim. Parashtruesi i kërkesës vendosi të paraqesë padi private në gjykatën e rregullt të Kosovës kundër drejtorit të Drejtorisë për Rindërtim në Komunën e Pejës.
26. Më 27 qershor 2013, Gjykata Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin P. nr. 470/13, e hodhi poshtë padinë private të Lulzim Ramajt si të pabazuar.

### ***C. Kërkesat KI04/14 dhe KI13/14***



27. Parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj ankohet se Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e veteranëve të UÇK-së nuk ia pranoi atij statusin e veteranit të UÇK-së.
28. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktvendimi për papranueshmëri nr. KI32/11 i Gjykatës, me parashtrues të kërkesës Lulzim Ramaj, që ka të bëjë me kërkesën për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së, të 20 prillit 2012, është i paligjshëm, i mungon arsytimi dhe se nuk është dashur të publikohet.
29. Për më tepër, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me vërejtjet si në vijim *“këtë herë kur të merrni një vendim, pa marrë parasysh a e aproveni ose refuzoni kërkesën, më ofroni arsytim ligjor dhe jo të veproni si deri më tani, të nxirrni vendime pa arsytim ligjor”*.

#### **Pranueshmëria e kërkesës KI228/13**

30. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse ata i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
31. Lidhur me kërkesën KI228/13, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:
 

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
32. Dispozita e lartcekur kushtetuese kërkon nga parashtruesit e kërkesës që t'i dorëzojnë kërkesat e tyre në Gjykatë në mënyrë ligjore, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike.
33. Gjykata i referohet Nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:
 

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”*.
34. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që parasheh:
 

*“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (...)*

*(b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”*.

35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Njoftimi KMLP. I. nr. 11/13, i Prokurorit të Shtetit, i 5 gushtit 2013, u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 7 gusht 2013.
36. Për më tepër, Gjykata vëren se edhe pse kërkesa KI228/13 ishte regjistruar më 10 dhjetor 2013, Gjykata do ta marrë parasysh datën e regjistrimit të vulës postare si datë kur kërkesa KI228/13 është parashtruar në Gjykatë, që është 7 dhjetori 2013 (shih rastin *Kiprici kundër Turqisë*, Nr. 14294/04, GJEDNJ, Vendimi i 3 shtatorit 2008).
37. Nga kjo rrjedh se kërkesa KI228/13 është parashtruar brenda afatit ligjor prej katër (4) muajve të paraparë me Nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.
38. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës Shahe Ramaj nuk ishte përfshirë, në asnjë fazë apo cilësi, në procedurat në gjykatat e rregullta. Gjykata vëren se ajo kishte parashtruar kërkesën KI228/13 së bashku me parashtruesin tjetër të kërkesës dhe se parashtruesja Shahe Ramaj vetëm ankohet se aktvendimet e Gjykatës janë *“janë të paligjshme dhe u mungon arsyetimi”*.
39. Gjykata përsërit se Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë”*.
40. Në kërkesën konkrete, parashtruesja Shahe Ramaj nuk ishte palë as në procedurë dhe as në kërkesat e mëparshme në Gjykatë KI102/11, KI32/11 dhe KI126/10, si dhe as në procedurat pasuese në gjykatat e rregullta. Nga kjo rrjedh se parashtruesja e kërkesës Shahe Ramaj nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar për të dorëzuar kërkesë, në kuptim të Nenit 113.7 të Kushtetutës.
41. Si rezultat, Gjykata duhet ta refuzojë kërkesën si të papranueshme për atë që ka të bëjë me Shahe Ramaj.
42. Sa i përket ankesave tjera, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj në këtë kërkesë, Gjykata vëren se ankesa themelore e parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me kushtetutshmërinë e Aktvendimeve për papranueshmëri në kërkesat 102/11, 32/11 dhe 126/10.
43. Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës, i cili parasheh:
- “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.*
44. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (3) f) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- (3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese:*
- ...
- f) kërkesa nuk është racione materiae në pajtim me Kushtetutën”.*



45. Gjykata vëren se vendimet e saj janë përfundimtare dhe detyruese dhe si të tilla nuk mund të kontestohen nga vetë Gjykata ose nga ndonjë autoritet tjetër publik.
46. Nga kjo rrjedh se këto ankesa, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj në kërkesën KI228/13 duhet të refuzohen nga Gjykata si *ratione materiae* të papajtueshme me Kushtetutën, siç parashihet në rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës.

#### **Pranueshmëria e kërkesës KI11/14**

47. Lidhur me kërkesën KI11/14, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

48. Gjykata i referohet Nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

49. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*(a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjyqimit të kundërshtuar”.*

50. Nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, Lulzim Ramaj nuk e ka kontestuar Aktvendimin P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, në instancat e larta të gjyqësorit të rregullt.
51. Nga kjo rrjedh se kërkesa KI11/14 duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse parashtruesi Lulzim Ramaj nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç kërkohet me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.



#### **KI04/14 dhe KI13/14**

52. Përkitazi me kërkesat KI04/14 dhe KI13/14, të dorëzuara nga parashtruesi Lulzim Ramaj, Gjykata i referohet Nenit 116.1 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.*

53. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (3) f) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*

...

*f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën”.*

54. Gjykata vëren se në kërkesat KI04/14 dhe KI13/14, parashtruesi i kërkesës, Lulzim Ramaj ankohet se Aktvendimi për papranueshmëri nr. KI32/11, parashtrues i kërkesës Lulzim Ramaj, i 20 prillit 2012, përkitazi me statusin e tij si veteran i UÇK-së, duke pretenduar *inter alia*, se ai është aktvendim i paligjshëm.

55. Gjykata vëren se vendimet e saj janë përfundimtare dhe detyruese dhe si të tilla nuk mund të kontestohen nga vetë Gjykata ose nga ndonjë autoritet tjetër publik.

56. Nga kjo rrjedh se kërkesat KI04/13 dhe KI13/14, përkitazi me parashtruesin e kërkesës, Lulzim Ramaj, janë hedhur poshtë nga Gjykata si *ratione materiae* të papajtueshme me Kushtetutën, siç parashihet me rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës.

#### **Pranueshmëria lidhur me kërkesat KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14**

57. Gjykata konsideron se përkundër kritereve të ndara të pranueshmërisë, të aplikuara në secilën kërkesë dhe të përfundimeve të bazuara në to, kërkesat duhet t'i përmbushin më së shumti kriteret e rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*

(...)

*d) Gjykata konsideron që kërkesa është keqpërdorim i të drejtës për petition;*

58. Sa i përket keqpërdorimit të së drejtës për kërkesë, Gjykata thekson se praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut shtjellon çështjen se kur ekziston keqpërdorimi i së drejtës për kërkesë. Një prej tyre është, *inter alia*, kur parashtruesi në mënyrë të përsëritur paraqet kërkesë të bezdisshme dhe qartazi të pabazuar në GJEDNJ, të cilat janë të ngjashme me një kërkesë që ai

ose ajo e ka parashtruar në të kaluarën që tashmë është deklaruar e papranueshme (shih *M. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), dhe *Philis kundër Greqisë* (vendim)).

59. Gjykata vlerëson se në rastet në fjalë, parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar kërkesa të pabazuara dhe të përsëritura. Kështu deri më tani, ata kanë parashtruar gjithsej tetë kërkesa në Gjykatë, përfshirë dhe të tanishmet.
- a. KI126/10, parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 19 janar 2012;
  - b. KI32/11 parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Kërkesë për njohje të statutit të veteranit të UÇK-së, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 20 prill 2012;
  - c. KI102/11, parashtruese e kërkesës, Shahe Ramaj kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 12 dhjetor 2011.
  - d. KI106/12, parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Kërkesë për njohjen e statusit të anëtarit të UÇK-së, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 29 janar 2013;
  - e. KI116/12, parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 25 janar 2013;
  - f. KI228/13, parashtrues të kërkesës, Lulzim Ramaj & Shahe Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. nr. 11/13, të 5 gushtit 2013, përkitazi me Aktvendimin për papranueshmëri, Rasti nr. KI126/10 i Gjykatës Kushtetuese, i 19 janarit 2012; Aktvendim për papranueshmëri, Rasti nr. KI32/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012; dhe Aktvendimi për papranueshmëri, Rasti nr. KI102/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 12 dhjetorit 2011, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 24 mars 2014;
  - g. KI04/14 & KI13/14, parashtrues të kërkesës Lulzim Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011, lidhur me Vlerësimin e kushtetutshmërisë, Rasti nr. KI32/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 24 mars 2014;
  - h. KI11/14, parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 24 mars 2014.



60. Gjykata konsideron se në rastet e tanishme, parashtruesit e kërkesës kanë dorëzuar kërkesa të pabazuara, të përsëritura, abuzive dhe të bezdisshme, duke penguar punën e Gjykatës dhe duke i marrë kohën dhe mjetet e saj.
61. Duke marrë parasysh të gjitha ato që u thanë më lart, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës përfitojnë nga e drejta për ankesë në mënyrë që të sulmojnë, denigrojnë dhe të njollosin reputacionin e gjyqtarëve si profesionistë dhe individë, dhe të Gjykatës si institucion i drejtësisë.
62. Për më tepër, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesve për moszbulimin e identitetit të tyre, si të pabazuar.
63. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesat KI228/13, KI04/14, KI11/14 dhe KI13/14 përbëjnë keqpërdorim të së drejtës për ankesë në pajtim me rregullin 36 (3) d) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të Nenit 113.7 të Kushtetutës; Nenit 47 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36 (3) d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 24 mars 2014, njëzëri

### **VENDOS**

- I. T'I HEDHË POSHTË kërkesat të papranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se kërkesat e tanishme përbëjnë keqpërdorim të së drejtës për ankesë, sipas formulimit të rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës;
- III. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesve për moszbulim të identitetit;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Snezhana Botusharova



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani